

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Pjesëmarrje Rinore dhe Politika Rinore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10/20), nenit 48-k të Statutit të Qytetit të Shkupit "Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 16/05, 8/10, 17/11, 18/13, 13/14, 1/15, 12/15, 19/4 dhe 21/9), Vendimit për përcaktimin e nevojës për shpalljen e Thirrjes publike për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Inicues për Konstituimin e Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 12/21) dhe Aktvendimit për themelimin e Këshillit Inicues për Konstituimin e Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit nr. 08-2185/3 nga 30.03.2022, të miratuar nga Kryetarja e Qytetit të Shkupit, Këshilli Inicues për themelimin e Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE për pjesëmarrje në Kuvendin Konstituv të të Rinjve të Qytetit të Shkupit

1. Përshkrim i shkurtër dhe kushte të përgjithshme

Kuvendi Konstituv Lokal i të Rinjve është organ nën kompetencën e të cilit është përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit Lokal Rinor (KLR) të Qytetit të Shkupit.

Për pjesëmarrje në Kuvendin konstitutiv mund të aplikojnë organizata rinore, organizata për të rinjtë, forume rinore të partive politike, organizata të nxënësve dhe studentëve dhe forma të tjera të shoqatave rinore që kanë aktivitete në territorin e qytetit të Shkupit (ka të bëjë me dhjetë komunat e Shkupit, Aerodrom, Butel, Gazi Baba, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare).

Kuvendi i të Rinjve të Qytetit të Shkupit zgjedh anëtarët e Këshillit Lokal Rinor të Qytetit të Shkupit të cilët do t'i përfaqësojnë më tej interesat e të rinjve dhe do të krijojnë politika të dedikuara për të rinjtë në territorin e qytetit të Shkupit. Këshilli Inicues për konstituimin e Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit inkurajon fuqimisht aplikimin e organizatave që punojnë në fusha të ndryshme me të rinjtë, si të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë nga komunitetet e marginalizuara etj. Inkurajon edhe organizatat që propozojnë delegatë dhe zëvendës delegatë që të udhëhiqen nga parimi gjithëpërfshirës, me qëllim përfaqësimin më të madh të të rinjve në Kuvendin e të Rinjve të Qytetit të Shkupit.

Detyra të Kuvendit Konstitutiv të të Rinjve të Qytetit të Shkupit

1. Shpall thirrje publike për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Lokal Rinor të Qytetit të Shkupit.
2. Zgjedh anëtarët e këshillit lokal rinor me zgjedhje të drejtpërdrejta me votim të fshehtë në të cilin të drejtë vote kanë delegatët e Kuvendit.
3. Krijon Rregulloren e punës për Këshillin Lokal Rinor.

Kushte për pjesëmarrje në Kuvendin Konstitutiv të të Rinjve të Qytetit të Shkupit

Në Kuvend mund të anëtarësohen:

1. Organizata rinore
2. Organizata për të rinj
3. Forume rinore të partive politike
4. Organizata të nxënësve dhe studentore
5. Forma të tjera të asociacioneve rinore

Format e organizimit dhe asociacionit nuk duhet të jenë detyrimisht të regjistruara në qytetin e Shkupit, por duhet të kenë veprimtari në territorin e qytetit të Shkupit.

Format e organizimit që janë anëtarë të asamblesë vjetore të të rinjve delegojnë delegat dhe zëvendës delegat.

Delegati dhe zëvendës delegati detyrimisht duhet të jenë banorë të Shkupit dhe të jenë në moshën nga 15 deri në 29 vjeç.

Konstituimi i Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit

Seancën konstituive të Kuvendit e thërret delegati më i vjetër i zgjedhur.

Në seancën konstituive të Kuvendit kryesuesi zgjidhet me votim të fshehtë.

Çdo anëtar i kuvendit mund të emërohet për kryesues, ose nëse propozohet dhe mbështetet nga të paktën 3 anëtarë të Kuvendit.

2. Mënyra e aplikimit dhe dokumentacioni i detyrueshëm

1. Portofoli i shoqatës, forumit rinor të partisë politike ose formës tjetër të shoqatës rinore (dokument jo më i gjatë se dy faqe i cili do të përmbajë informacion të përgjithshëm për punën e organizatës, vizionin dhe misionin e organizatës, aktivitetet kryesore, informacione për drejtuesin e organizatës, informacione kontakti për organizatën (adresa, telefoni kontaktues, faqja e internetit, etj.).
2. Raport për aktivitetet me të rinjtë të shoqatës në vitin e kaluar, forumit rinor të partisë politike, përkatësisht formës tjetër të shoqatës rinore në territorin e qytetit të Shkupit.
3. Formulari i plotësuar për nominimin e delegatit dhe zëvendës delegatit në Kuvendin Lokal të të Rinjve të Qytetit të Shkupit (Aneksi 1)
4. Letër motivuese e organizatës në të cilën do të shtjellohen arsyet pse organizata dëshiron të jetë anëtare e Kuvendit, mënyra se si mendon se mund të kontribuojë në punën e Kuvendit jo më të gjatë se një faqe.
5. Biografi e shkurtër e delegatit dhe zëvendës delegatit të propozuar
6. Dëshmi se delegati i dhe zëvendës delegati i propozuar janë banorë të Shkupit dhe se janë të moshës nga 15 deri në 29 vjeç..
Të depozitohet kopje e dokumentit publik (kartë identiteti ose pasaportë) e delegatëve të propozuar.

3. Afati i depozitimit të aplikimeve

Thirrja publike zgjat **10 ditë kalendarike**, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Thirrja publike shpallet më **20.06.2022** dhe zgjat deri më **29.06.2022**.

Të gjitha organizatat e interesuara që me propozimet e tyre plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në Kuvendin Konstituiv të të Rinjve të Qytetit të Shkupit, është e nevojshme të depozitojnë aplikimet në Qytetin e Shkupit, me postë në adresën: Bulevardi "ILINDEN" nr. 82 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më **29.06.2022** deri në orën 15:00, me shënimin: "**Aplikim për pjesëmarrje në Kuvendin Konstituiv të të Rinjve të Qytetit të Shkupit**".

Aplikimet depozitohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shenja të aplikuesit, i cili depoziton aplikimin.

VËREJTJE: Aplikimet e parregullta të cilat nuk janë depozituar në mënyrën siç kërkohet në tekstin e lartpërmendur, përkatësisht përmbajnë të dhëna jo të plota dhe dokumentacion jo të plotë, si dhe ato që nuk do të depozitohen në afatin e caktuar, nuk do të shqyrtohen

4. Informacione plotësuese

Informacione plotësuese mund të merrni në telefonin 3297-238 dhe 3297-320.

Për më shumë informacione rreth këshillave lokale të të rinjve mund t'i lexoni në dokumentet e mëposhtme:

1. Ligji për Pjesëmarrje Rinore dhe Politika Rinore, në dispozicion në:
<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/862649465cf4432aadcb4119f52bfd81.pdf>
2. Udhëzues për këshillat lokale rinorë, në dispozicion në:
<https://www.osce.org/mk/mission-to-skopje/491135>

**QYTETI I SHKUPIT
KËSHILLI INICIUES**